

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqipëria mposht Bjellorusinë, Gjimshiti, Ismajli dhe Muçi flasin pas ndeshjes
ADRESA	https://lapsi.al/shqiperia-mposht-bjellorusine-gjimshiti-ismajli-dhe-muci-flasin-pas-nde-shjes-i1094560
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 21:18:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 21:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8ce1bd57e1a5683e643d3b541659bcc4d86190c40fa99724feb6211aee54e7b
TEKSTI	cd22e7680bab6498a80edc07e4951b313075cdf7f888aa06fcff2fd74412a0e8
PAMJA	e69c9a4a1ac2e35d75ee433ee48ebac28696736a9cd696661c6359865f5545a4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	551f2fded59a0818c0ae43a0432e3e2400b4faeab421a6ac05e819c389d56189
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d57e76f0635dd627857df971352a88661d14843f3cba35c03307d6141131e1c1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/551f2fded59a0818c0ae43a0432e3e2400b4faeab421a6ac05e819c389d56189>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shqipëria mposht Bjellorusinë, Gjimshiti, Ismajli dhe Muçi flasin pas ndeshjes

LAPS1.AL • 26 SEPTEMBER 2026



Shqipëria e nisi me fitore aventurën në Ligën e Kombeve, duke mposhtur 2-0 Bjellorusinë në shtëpi. Pas ndeshjes, Berat Gjimshiti, Ardian Ismajli dhe Ernest Muçi folën për paraqitjen e skuadrës, skemën e lojës dhe objektivat e Kombëtares.

Berat Gjimshiti: "Aspekti fizik dhe mental është shumë i rëndësishëm"

Kapiteni i Kombëtares, Berat Gjimshiti, vlerësoi fitoren, por theksoi se skuadra ka ende hapësirë për përmirësim në fillimin e aventurës me trajnerin Maran.

"Ka për t'u përmirësuar, është vetëm fillimi i trajnerit Maran. Një Ligë e Kombeve e re, për një kualifikim në European. Në topat e dytë ishin më agresivë dhe fituan më shumë duela. Me kalimin e kohës morëm në dorë lojën, shkuam në avantazh, u bëmë më thjeshtë.

Aspekti fizik dhe mental është shumë i rëndësishëm. Duhet të jemi të përqëndruar dhe të japim maksimumin për të arritur diçka me Kombëtaren."

Gjimshiti sqaroi edhe hierarkinë e gjuajtësve të penalltive: "Lista kush e gjuan penalltinë është e përcaktuar. Asllani është i pari, Rei i dyti. Është më mirë për ne, kur gjuajtësit shënojnë".



ide



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm
Andi Bushati



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit
Armand Shkullaku

MOTITIRANA

14°C

KËMBIMIEURO

91.97

aktuale

22:06

Rama nis sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit

21:31



Rama mbron projektin nga New Yorku: Zvërneci vlen miliarda, kundërshtarët "sharlatanë"



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku





Ardian Ismajli: "Kemi merituar të fitonim edhe me rezultat më të thellë"

Ardian Ismajli e cilësoi fitoren veçanërisht të rëndësishme pas dy humbjeve në ndeshjet miqësore të qershorit, duke vlerësuar dominimin e Shqipërisë.

"Ishte shumë e rëndësishme pas dy miqësoreve të humbura në qershor. Kemi reflektuar, kemi dominuar kundërshtarin. Në 10 minutat e para kishim vështirësi, por ekipi që vuan ia del. Kishim mundësi për më shumë goli, por me rëndësi 3 pikët dhe që ia filluam me këmbën e mbarë.

Përshtypje shumë pozitive. E kemi dominuar kundërshtarin në çdo aspekt. Kemi merituar të fitonim edhe me rezultat më të thellë. Shpresoj t'i bëjmë rrugën vetes shumë më të lehtë për European."

Ismajli foli edhe për mënyrën se si Shqipëria e përballoi presingun e Bjellorusisë: "Nuk kemi pritur që Bjellorusia do luajë presing, kemi pritur pak mbrapa. Jemi lojtarë të Seria A, dimë të mbrohemi. Morëm ndeshjen në kontroll dhe bëmë atë që duhej".



Ernest Muçi: "Sot luajtëm me skemën 4-4-2, atje ndihem më mirë"

Ernest Muçi, i cili shënoi golin e dytë të Shqipërisë, u shpreh i lumtur për rikthimin dhe për fitoren, ndërsa theksoi se ndihet më mirë në skemën 4-4-2.

"Jam shumë i lumtur që u riktheva. Ishte shumë e rëndësishme ta fitonim këtë ndeshje. Falenderoj trajnerin për besimin. Kemi 3 ndeshje të tjera, për të dalë të parët në grup. Golin ia dedikoj familjes time, të dashurës dhe gocës time.

Sot luajtëm me skemën 4-4-2, atje ndihem më mirë, mund të tregoj aftësitë e mia. Është skemë e mirë për të gjithë. Sot treguam që fituam me këtë skemë dhe duhet të vazhdojmë."

Muçi foli edhe për eksperiencën e tij me Kombëtaren: "Ishte ndeshja ime e katërt në 5 vjet si titullar me Kombëtaren dhe goli i katërt, shpresoj të vazhdoj të jap kontributin tim."

Të këshilluara



Asllani e Muçi i japin fitoren e parë Maran në Nations League: Bjellorusia dorëzohet në Tiranë



Qeveria lëviz emrat: Kush ikën dhe kush vjen



Zbardhen debatet në gjyq të "shokëve" të Ergys Agasit/ "Pse Vlora Hysenin s'e mbani në burg?"



Saimir Tahiri paralajmëron rikthimin: Do shihemi së shpejti, ka qaq shumë për të thënë



Operacion i befasishtëm i SPAK, arrestohet në Shkodër Bledar Cafi/ Rishpallet në kërkim Indrit Dokle



Shqipëria e nis me fitore 2-0 aventurën në Nations League dhe ndërpret serinë e pesë humbjeve radhazi. Fitorja e parë në...



“Hesht, i hëngre dy”, Lukaku e provokoi, tërbohohet Donnarumma: inati i së kaluarës në Itali-Belgjikë

Gigio Donnarumma dhe Romelu Lukaku ishin protagonistët e momenteve të tensionuara në fund të ndeshjes mes Italisë dhe Belgjikës në Nations League.



Manchester City fajtor për 114 shkelje financiare: mund të përjashtohet nga Premier League, çfarë ndodh me trofetë



Asllani në dyshim, Mitaj ulet në stol: Maran ndryshon formacionin, ja si pritet të rreshtohet Shqipëria

Sipas të gjitha atyre që janë parë në këto ditë përgatitje, do të jetë një Shqipëri ndryshe ajo që do të zbrisë në fushë përballë Bjellorusisë.



Maran debuton, por Bjellorusia do të jetë menjëherë vendimtare: italianin e ka nisur me dy humbje

Numërimi mbrapsht për debutimin në Nations League pothuaj ka mbërritur në fund, edhe pse për Rolando Maran dhe stafin e tij kanë mbetur ende gjëra për tu përmirësuar deri kur Shqipëria dhe Bjellorusia të zbrisin në fushë sonte në orën 20.45.



Kush është Bjellorusia e Goncharenkos: pas humbjes me Skocinë, ata kanë një seri prej gjashtë rezultatesh pozitive

Bjellorusia, që Shqipëria do të ketë përballë në nisjen e Nations League, mund të jetë një skuadër pa emra të mëdhenj në futbollin evropian, por vjen në këtë përballje me një seri prej gjashtë ndeshjesh pa humbje.





Kombëtarja nuk humbet prej 16 vjetësh me Bjellorusinë: ja si u përmbysën hierarkitë, Goncharenko



Italia, kundër Belgjikës natë e errët dhe vërshëllima: Mancini e nis me makth, Romano katranos debutimin

Italia e teknikut Mancini, në rikthimin e tij, humbet ndeshjen e parë të sezonit në Nations League në "Olimpico", ndaj Belgjikës, e cila fiton 2-0.



Roberto Carlos, mashtrimet e divorci: "Kam humbur 99% të parave të fituara nga futbolli"

Roberto Carlos ka humbur pothuajse të gjitha paratë që ka fituar si futbollist, duke mbetur me llogarinë praktikisht bosh dhe me një pasuri që duhet ta rindërtojë.



Tërmet te Manchester City, konsiderohet fajtor për 114 nga 115 shkeljet financiare: ja çfarë do të ndodhë

Manchester City është shpallur fajtor për pothuajse të gjitha 115 akuzat që lidhen me shkeljet e pretenduara të rregullave financiare të kampionatit elitare anglez.


Me sytë katër



21:35

"Më shau, e shava"/ Shefi i komisariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës

Një situatë e paprecedentë raportohet të ketë ndodhur një muaj më parë në qytetin e Durrësit, ku shefi i Komis...



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44



Kryemadhi: Si nuk i fiku njeri radarët për ne! Meta vetëm i ndizte

20:36



PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

22:43

SPORT

→ Të tjerë artikuj





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.